

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA E LIPJANIT**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **613-24-9854-5-1-1**

Sa i përket tenderit për **“Asfaltimi i rruges Marie Shllaku dhe ndërtimi i urës mbi Lumin Sitnica në Rufc të Ri”**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

BENI - COM SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Shkabaj, Obiliq

(Adresa)

Obiliq

(Vendi)

045/444999

(Numri Telefonit)

15000

(Kodi postar)

-

(Numri i Faks-it)

Muhamet Kunushefci

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

beni-com@hotmail.com

(Adresa elektronike)



31.03.2025

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës e parashtron ankesën përmes përfaqësuesit zyrtar të kompanisë.

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

1. Njoftimi për kontratë i datës **20.09.2024.**
2. Dosja e tenderit e datës **20.09.2024.**
3. Procesverbali i hapjes i datës **05.11.2024.**
4. Njoftimi mbi vendimin e AK-se i datës **21.11.2024.**
5. Kërkesa për rishqyrtim e datës **26.11.2024.**
6. Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim i datës **27.11.2024.**
7. Ankesa ne OSHP e datës **09.12.2024.**
8. Raporti i ekspertit shqyrtues i datës **31.12.2024.**
9. Vendimi i SHP-se i datës **12.02.2025.**
10. Njoftimi mbi vendimin e AK-se hera e dyte i datës **12.03.2025.**
11. Letrat standarde te datës **12.03.2025.**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Menjëherë pas pranimi të vendimit mbi rivlerësimin ne kemi bërë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare me datë 12.03.2025.

Pas analizimit të këtyre dokumenteve mund të thuhet se gjatë procedurës formale të vlerësimit të tenderëve që kanë marrë pjesë në këtë aktivitet prokurimi, nxjerrjes së vendimeve kontradiktore, AK nuk ka zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme dispozitat ligjore procedurale dhe materiale të LPP-së për shkak se gjatë mënyrës dhe metodës së vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve, nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit dhe dispozitat ligjore që përcaktojnë kushtet dhe kërkesat e trajtimit të barabartë të OE në procesin e vlerësimit.

Pas kësaj ne kemi vazhduar me kërkesë për rishqyrtim pranë AK e dorëzuar me datë 17.03.2025 derisa përgjigja na është kthyer me datë 20.03.2025 në bazë të vendimit me të cilin AK nuk i ka marrë parasysh argumentet tona për vlerësimin kundërligjor që është bërë në lidhje me këtë AP dhe në të njëjtën kohë ka vazhduar me shkelje tjera të rënda të LPP-së si dhe legjislacionit sekondar Rregullores për Prokurim Publik Nr. 001/2022. Si rrjedhojë në i drejtohem OSHP-së në mënyrë që të parandalojmë shkeljen e Ligjeve në fuqi nga AK.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet e LPP-se nga ana e AK-së:

Neni 1 Qëllimi.

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti.

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi.

Neni 27 Dosja e Tenderit.

Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahاسimi i Tenderëve.

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës.

Gjithashtu AK ka shkelur edhe dispozitat përkatëse të KRPP-se.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të pa kënaqur me njoftimin e datës 12.03.2025 mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues KOMUNA E LIPJANIT në lidhje me aktivitetin e prokurimit: Asfaltimi i rruges Marie Shllaku dhe ndërtimi i urës mbi Lumin Sitnica në Rufc të Ri me nr. te prokurimit: 613-24-9854-5-1-1 në afatin ligjor konform nenit 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, kemi ushtruar këtë kërkesë për rishqyrtim dhe ushtrojmë këtë ankesë:

Për shkak se AK- LIPJANIT:

1. Në mënyrë të kundërligjshme ka bërë eliminimin e ofertës tonë me arsyetimin:

Iso standardet e prezantuara nga ana juaj nuk janë të standartizuara në fushën e këtij projekti, por të njëjtat janë për Zhvillime të projekteve të ndërtimit të lartë.

Këto arsyeime nuk janë të bazuara dhe nuk e pasqyrojnë realitetin dhe gjendjen faktike por si të tilla paraqesin fakte të rreme me qëllim të justifikimit të këtij vendimi i cili është në kundërshtim me parimet dhe kriteret e nenit 59, nenit 69 të LPP-së lidhur me nenin 40 paragrafi 1,2 dhe 6 të RrPP nr. 001/2022.

Ne kemi dorëzuar ISO standardet konform kërkesës në FTD.

Mirëpo AK duke pasur qëllim dhe shkas të caktuar para vetes eliminimin tonë me çdo kusht, pa dhënë asnjë shpjegim dhe arsye të bazuar mbi faktet vendimtare dhe dispozitat ligjore të LPP-së shkel parimet e drejtësisë dhe arsyes njerëzore, duke abuzuar qëllimisht me detyrën zyrtare ndërmerr masa të jashtëligjshme në kundërshtim me kërkesat procedurale dhe qenësore të legjislacionit të prokurimit me qëllim të eliminimit të parashtruesit të ankesës dhe krijimit të rrethanave për të krijuar një rezultat të caktuar duke favorizuar OE të caktuar. Pra, me këtë AK ka vlerësuar padrejtësisht ofertën tonë si të papërgjegjshme kështu duke bërë shkelje të Nenit 7.1, Nenit 59.4 të LPP-së si dhe Nenit 40.1 të RrPP-së.

Oferta jonë është e plotë dhe e saktë me të gjithë dokumentet e saj shoqëruese në përputhje me të gjitha kriteret dhe dokumentet (dëshmitë) e tenderit të përcaktuara nga AK në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit.

2. Në mënyrë të kundërligjshme ka rekomanduar për kontratë Grupin e Operatoreve Ekonomik të pa përgjegjshëm të cili nuk i kanë plotësuar te gjitha kërkesat e Autoritetit Kontraktues (AK-se) te vendosura ne Njoftim për kontrate (NJK) dhe në Dosje te Tenderit (DT)

Sqarojmë në mënyrë të detajuar :

Autoriteti Kontraktues KOMUNA E LIPJANIT me datën 12.03.2025 ka bere publikimin e Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku, mënyrë të kundërligjshme ka rekomanduar për kontrate Grupin e Operatoreve Ekonomik te pa përgjegjshëm të cili nuk i kanë plotësuar te gjitha kërkesat e Autoritetit

Kontraktues (AK-se) te vendosura ne Njoftim për kontrate (NJK) dhe në Dosje te Tenderit (DT.) i mbetet AK-se qe te beje ekzaminimin krahasimin dhe vlerësimin e ofertave ne mënyrë te drejte dhe pa diskriminim. Vetëm i bëjmë me dije AK-se se GOE te rekomanduar për kontrate është i pa përgjegjshëm dhe nuk i ka plotësuar te gjitha kërkesat e Autoritetit Kontraktues (AK-se) te vendosura ne Njoftim për kontrate (NJK) dhe në Dosje te Tenderit (DT.)

AK është dashur ta eliminoj këtë GOE, pasi qe konform nenit 4 paragrafi 1.26 i LPP-së, përkitazi me nenin 111 paragrafi 1-8 i LPP-së, GOE i shpallur fitues me vendimin e datës 13.03.2025 ne këtë aktivitet te prokurimit pasi qe ky GOE është pajtuar qe te mos e fitoj këtë tender me momentin e publikimit te AK-se te B58 Njoftimi mbi vendimin e AK-se te datës 21.11.2024 i njëjti nuk ka parashtruar fare kërkesë për rishqyrtim e as ankese ne OSHP. Pra Ky GOE nuk ka interes Juridiko material për këtë aktivitet te prokurimit pasi qe AK është dashur te vazhdoj vetëm me Operatorete qe kane qene ne gare për këtë aktivitet e jo edhe me ata te cilët kane heq dore vullnetarisht nga ky aktivitet siç është rasti me GOE te shpallur fitues. Pra ky OE nuk ka atakuar vendimin filletar të AK-së.

Me publikimin e B58 Njoftimi mbi vendimin e AK-së të datës 21.11.2024 neve kemi kërkuar qasje nga AK te gjithë dokumentacionit dhe AK nuk na ka ofruar qasje për këtë GOE pasi qe neve qysh ne kërkesën e pare për rishqyrtim dhe ankesën ne OSHP do ti kishim pretendimet tona edhe ndaj këtij GOE. Si dëshmi e kemi emalin e datës 25.11.2024 ku kemi kërkuar te gjitha ofertat por AK nuk na ka dërguar.

 Outlook

Re:

From Ismet Kunushevci <beni-com@hotmail.com>

Date Mon 11/25/2024 14:26

To Zyra Prokurimit Lipjan Lipjan <transferemail.lipjan@gmail.com>

Te nderuar,

Pershendetje... Dosjen e vali invest e more, ju faleminderit, Ju lutem per projektin e njejte na duhen edhe ofertat e te gjith operatoreve te tjer.

Ju lutem na i dergoni ne email ne kete gjithashtu ne agronselmani@gmail.com.

Kisha ardh me i mar prap por pasi qe ne USB nuk po mi qitni mi dergoni prap ne email nese duhet porcerverbal me nenshkru ju lutem ma dergoni ne mail ua kthej te nenshkruare.

Me respekt,

Sikur te kishim patur qasje neve do ti kishim parashtruar pretendimet tona ne kërkesën për rishqyrtim te datës 26.11.2024 gjithashtu edhe ne ankesën tone te dorëzuar pranë OSHP-se te datës 09.12.2024 dhe OSHP siç na ka aprovuar pretendimet tona qe i kemi parashtruar do te na kishte aprovuar edhe këto pretendime pasi qe edhe me vendimin e OSHP-se me numër OSHP: 2024/1189 te datës 12.02.2025 është konstatuar qe AK ka bere shkelje te dispozitave te LPP-se dhe lënda është kthyer ne rivlerësim.

Përveç qe është pale pa interes gjithashtu GOE është edhe i pa përgjegjshëm, ku ne vijim po i paraqesim pretendimet tona lidhur me papërgjegjshmërinë e këtij GOE.

Sqarojmë se AK ne NJK dhe DT ka parapare kërkesën tek :

1. Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional: Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka perfunduar me sukses kontratat për projekte të ngjashme në vlerë prej 750,000.00 Euro per (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontrat.

Dëshmia e kërkuar dokumentare: Dëshmia 1. Nje liste e kontratave e nenshkruar dhe vulosur nga OE ku do të bëhet përshkrimi me këto informata titullin e kontratës, klientin, datën e fillimit të kontratës, datën e përfundimit të kontratës, vlerën e kontratës, Referencat apo pranimin teknik kopje për kontratat e prezentuara per projekte te ngjashme, Nese kontrata me reference eshte me kompani private te deshmohet me transaksion bankar (deshmi qe eshte kry pagesa). Referencat apo pranimet teknike duhet te jene ne 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontrat.

GOE për këtë kërkesë ka ofruar vetëm kontrata për asfalt e jo edhe kontrata për URA pasi qe vet kërkesa e AK-se është kontrata te ngjashme dhe ky lloj aktiviteti i prokurimit është Ndërtimi i Urave dhe asfaltimi i rrugës pra GOE është dashur te prezantoj referenca edhe për asfaltim edhe për ndërtim te urave, si mund te i jepet një kontratë dikujt kur nuk e ka punuar atë pune asnjëherë, nuk kane ndërtuar URA, pra kjo nuk është loje pasi qe rrezikohet jeta e qytetareve dhe kush e merr përgjegjësinë ne te ardhmen nëse do te ketë shembje te urës.

1. Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional: Kërkesa 2. Lista e stafit d) Min 2 teknik i diplomuar i ndërtimtarisë min 5 vite përvojë pune.

Dëshmia e kërkuar dokumentare: Dëshmia 2. Lista e stafit duhet te dorëzohet e nenshkruar dhe e vulosur nga OE. Per piken (D - F) të dorëzohen dëshmitë sipas kërkesës, Per te gjith stafin kerkohen Kontratat e punes, ose parakontratat e punes me validitet dhe kohesgjatje te kete projekti. Per diplomat e fituara jashte Republikes se Kosoves kerkohen qe te jene te Nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Republika e Kosoves.

Siç po shihet nga kjo kërkesë AK ka kërkuar min 2 teknik te diplomuar te ndërtimtarisë me min

5 vite përvojë pune, ndërsa GOE i rekomanduar për kontrate ka ofruar një teknik te ndërtimtarisë dhe një inxhinier te ndërtimtarisë si me poshtë:

LISTA E PERSONELIT&PUNËTORËVE

Nr.	Emri	MBIEMRI	POZITA	Me kontratë kontratë mbi vepër
1	Albion	Vogliqi	Drejtor/Pronar	
2	Mefail	Deda	Teknik I ndërtimtarisë	Konrate mbi veper
3	Qendrim	Gecaj	Inxhinier I diplomuar I ndërtimtarisë/teknik I ndërtimtarisë	Konrate mbi veper

Nentore 2024



Pra neve jemi te vetëdijshëm qe shkollimi i inxhinierit është me i lart sesa shkollimi i teknikut por përvoja e punës e prej 5 vite si teknik i ndërtimtarisë inxhinieri nuk e ka pra këtë kërkesë nuk e plotëson GOE i rekomanduar për kontrate, AK ka kërkuar

edhe inxhinierë tjerë si ne piken a), piken b) te kësaj kërkesë dhe OE i ka prezantuar ata inxhinier ndërsa ne piken d) AK ka kërkuar teknik te diplomuar te ndërtimtarisë me min 5 vite përvojë pune. Në kërkesën për sqarime shtese nga ana e AK-se lidhur me këtë pike AK nuk është dashur ti pranoj ato sqarime pasi që janë të krijuara pas hapjes së ofertave dhe një gjë e tillë është në kundërshtim me nenin 72 të LPP-se ku në mënyrë decitive, sipas pikës 3 të nenit 72 përcaktohet se:

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit

1. për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Pra përveç që për këto dokumente ekzistenca e tyre nuk është e fiksuar pasi që nuk janë të noterizuara dhe shihet qarte se GOE i ka krijuar në momentin e kërkesës së AK-se gjithashtu sipas ligjit ekzistenca e tyre të mund të verifikohet në mënyrë objektive dhe një gjë e tillë është e pamundur pra nuk mund të verifikohen në mënyrë objektive se këto dokumente kanë ekzistuar edhe para hapjes së ofertave.

AK është dashur ta eliminoj këtë GOE pasi që nuk e ka plotësuar këtë kërkesë të AK-se dhe shihet qarte se ky GOE edhe në këtë pike është i pa përgjegjshëm.

Poashtu AK ka kërkuar sqarime nga GOE i rekomanduar për shpërblim me kontratë në lidhje me inxhinierat Driton Mulaj, Rilind Elshani, Qendrim Gecaj, Valon Mezraja dhe 10 punëtorët tjerë, duke kërkuar kontratat e reja pasi kontratat e dorëzuar nuk kanë plotësuar kërkesën në FTD e cila ka qenë e paraqitur shumë qartë:

Per te gjith stafin kerkohen Kontratat e punes, ose parakontratat e punes me validitet dhe kohesgjatje te kete projekti.

Pra ky GOE ka paraqitur inxhinierat në fjalë me kontrata të cilat nuk e përmbushin kriterin e vendosur nga ana e AK-së në FTD, në bazë të kësaj ky GOE do duhej të eliminohej dhe jo të kërkohej sqarime shtesë për dokumente të cilat i kanë poseduar dhe se është e fiksuar data e tyre.

Në përgjigje të kërkesës për sqarime ky GOE ka dorëzuar kontratat e reja që fillojnë prej datës 06.01.2025 që nënkupton se janë përpiluar pas datës së dorëzimit të ofertave. Me këtë AK ka bërë shkelje të Nenit 72 të LPP-së.

3. Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional: *Kerkesa 3. Lista e pajisjeve teknike k) Paisje metalike per shallona betoni = (min 400 m2),*

Dëshmia e kërkuar dokumentare: Dëshmia 3. Lista e paisjeve e nënshkruar dhe vulosur nga OE, Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë OE duhet të ofroj marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve me deshmite sipas kërkesës me lartë. Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të këtij projekti e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët.

GOE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar një marrëveshje me NOVA shpk Ferizaj për marrjen me qira për pajisje metalike për shallona betoni ku NOVA shpk ka prezantuar një DUD doganor që këto pajisje i ka të drrasave e jo të metalit ashtu siç është kërkuar si dhe në DUD figuron se të gjitha ato dërrasa me elemente alumini janë 17840kg ndërsa AK ka kërkuar k) Paisje metalike për shallona betoni = (min 400 m2), AK është dashur ta eliminoj këtë GOE pasi që nuk e ka plotësuar këtë

kërkesë të AK-se dhe shihet qarte se ky GOE edhe ne këtë pike është i pa përgjegjshëm.

8 Marrësi / Importuesi NOVA SH.P.K. Cërmetë, Ferizaj		Nr 81030277		9 Personi përgjegjës financiar NOVA SH.P.K. Cërmetë, Ferizaj		Nr 81030277	
10 Vendi		11 Vendi i		12 Detajet e vlerës		13 P.P.R	
XK		XK		1,400.00			
14 Deklaruesi LONA SHPED SH.P.K. Reçakut Ferizaj		Nr 810303082		15 Vendi dërgues/eksportues GJERMANIA		16 Vendi origjinës GJERMANIA	
17 Vendi i destinacionit KOSOVA		18 Identiteti dhe nacionaliteti i mjetit transportues në nisje/arritje VR129PB AC511YR XS		19 no		20 Kushtet e dërgesës FCA HATERDACH	
21 Identiteti dhe nacionaliteti i mjetit aktiv transportues që kalon kufirin VR129PB AC511YR XS		22 Valutë dhe shuma e përgjithshme EUR 7,000.00		23 Kursi i këmbimit 1.0000000		24 Lloji i transaks.	
25 Lloji transportit 30 në kufi		26 Lloji transportit 30 Transport		27 Vendi ngarkimit/shkarkimit		28 Të dhëna financiare dhe bankare - Kushtet e pagesës	
29 Zyra doganore hyrëse/ dalje 3041 PKK DHEU I BARDHË		31 Lokacioni i mallrave		32 Artikulli 1 No.		33 Numri tarifor 73031000 00	
34 Kodi origjinës a DE b		35 Pesha bruto (kg) 17,840.00		36 Preferenca MSA		37 Procedura 4000 000	
38 Pesha neto (kg) 17,840.00		39 Kuota		40 Dokumenti paraprak/dok. përmbledhës 1		41 Njësia plotësuese	
42 Çmimi për njësi		43 M.V.		44		45	

Në kërkesën për sqarime shtese nga ana e AK-së lidhur me këtë pike AK nuk është dashur ti pranoj ato sqarime pasi qe janë te krijuara pas hapjes se ofertave dhe një gjë e tille është ne kundërshtim me nenin 72 te LPP-se ku ne mënyrë decitive, sipas pikës 3 te nenit 72 përcaktohet se:

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

3. Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Pra përveç qe për këto dokumente ekzistenca e tyre nuk është e fiksuar pasi qe nuk janë te noterizuara dhe shihet qarte se GOE i ka krijuar ne momentin e kërkesës se AK-se gjithashtu sipas ligjit ekzistenca e tyre te mund te verifikohet ne mënyrë objektive dhe një gjë e tille është e pamundur pra nuk mund te verifikohen ne mënyrë objektive se këto dokumente kane ekzistuar edhe para hapjes se ofertave.

Poashtu edhe **GOE Valdini SHPK & IBRAHIM KURRUMELI B.I.** konform nenit 4 paragrafi 1.26 i LPP-së, përkitazi me nenin 111 paragrafi 1-8 i LPP-së është pajtuar me vendimin e AK-së duke mos e atakuar të njejtin tender me momentin e publikimit te AK-se te B58 Njoftimi mbi vendimin e AK-se te datës 21.11.2024 dhe të datës 12.03.2025 pra i njëjti nuk ka parashtruar fare kërkesë për rishqyrtim e as ankese ne OSHP. Pra Ky GOE nuk ka interes Juridiko material për këtë aktivitet te prokurimit.

Zyrtaret e AK me këtë vendim po tentojnë ta dëmtojnë neve dhe buxhetin e Komunës. Me këtë veprim AK ka bere shkelje te nenit 1 te LPP-së ku thuhet se: vendimet e AK-ve, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-

diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji.

Autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Gjithashtu Autoriteti kontraktues nuk ka vepruar në harmoni me nenin 6 të LPP-së, ku autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu shihet qarte se AK ka bërë shkelje të nenit 7 të LPP-së ku në pikën 1 thuhet se : Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Ndërsa në pikën 2 thuhet : Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik. Gjithashtu AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59.4 të LPP-së ku thuhet:

Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Tenderi i GOE nuk është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit

AK për këtë aktivitet të prokurimit: ekzaminimin vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve nuk e ka bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk e ka respektuar edhe nenin 60 të LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës ka qenë tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët.

Pra neve kemi dorëzuar tender i cili është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit dhe kemi ofertuar me tenderin e përgjegjshëm me Çmimin më të ulët.

Besojmë se i kemi elaboruar me shumë se sa që duhet shkeljet e AK-se në këtë aktivitet të Prokurimit andaj, Kërkojmë nga AK që ti respektoj në përpikëri dispozitat ligjore që janë në fuqi lidhur me këtë lloj të aktivitetit të prokurimit dhe të nxjerr:

V E N D I M

- **APROVOHET si e bazuar** ankesa e Operatorit Ekonomik : “BENI-COM” SH.P.K. në lidhje me aktivitetin e prokurimit: Asfaltimi i rruges Marie Shllaku dhe ndërtimi i urës mbi Lumin Sitnica në Rufc të Ri me nr. të prokurimit: 613-24-9854-5-1-1 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues KOMUNA E LIPJANIT.
- **ANULOHET** njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues KOMUNA E LIPJANIT në lidhje me aktivitetin e prokurimit: Asfaltimi i rruges Marie Shllaku dhe ndërtimi i urës mbi Lumin Sitnica në Rufc të Ri me nr. të prokurimit: 613-24-9854-5-1-1 dhe lënda të kthehet në Rivlerësim dhe pas rivlerësimit të shpallemi fitues i këtij aktiviteti të prokurimit.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shpenzimet mbi angazhimin në përgatitjen e ofertave, sigurimin e ofertës, shpenzimet për shërbime të avokatisë dhe fitimin e humbur.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Ankesës i bashkangjiten në kopje dokumentet, faktet, provat e konstatuara më lartë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*